



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 221/2 prot.

Tiranë më 30.3.2021

V E N D I M

Nr. 19, datë 30.3.2021

PËR

LEJIMIN E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 221 prot., datë 28.01.2021, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri tek marrësi “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” në Turqi.

KONSTATOVA SE:

Subjekti kontrollues, “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri, ka kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale tek marrësi “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” i vendosur në Turqi.

Sipas deklarimeve të subjektit në Formularin e Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, administruar pranë Zyrës së Komisionerit, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Komisioneri përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Jeta profesionale;
- Numri i sigurimit shoqëror;
- Formimi – Diplomat – Medaljet;

- Adresa (karakteristikat e banesës);
- Foto;
- Informacioni i kontaktit, vlerësimet e pikëve të performancës, nënshkrimi.

Shteti ku do të realizohet transferimi: *Turqi*.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhëna personale janë:

- Nëpunës;

Frekuenca e Transferimit është: *Vazhdimisht*.

Qëllimi i transferimit, citojmë: *“Për të rritur performancën e aktiviteteve të kompanisë brenda hapësirave ligjore, për përmirësimin e databazës së informacioneve dhe përdorimin e sipas nevojës së subjektit, për të përmbushur obligimet dhe pritshmëritë/kënaqësinë e punonjësve, për rekrutime brenda kompanisë dhe ofrimin e mundësive të karrierës, për përmirësimin e shërbimit të burimeve njerëzore, menaxhimin e eventeve dhe aktiviteteve të kompanisë, siguria dhe autorizimet e aksesit të punonjësve, çështje ligjore, aktivitete trajnimi për zhvillimin e aftësive të punonjësve on site apo on line, aktivitete analizimi dhe marketingu.”*

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit, Rrethanat lidhur me përpunimin, subjekti transferues ka deklaruar: *“Informacioni do të mblidhet fizikisht dhe / ose elektronikisht nga punëmarrësi. Përpunimi i të dhënave do të jetë subjekt përdorimi vetëm brenda hapësirave ligjore, për qëllimet e specifikuara më sipër.”*

Në lidhje me rubrikën 8, Natyra e përpunimit dhe kohëzgjatja e tij, citojmë: *“Përpunimi i të dhënave do të kryhet brenda detyrimeve ligjore. Të dhënat do të merren të punësuarve aktualë dhe çdo individ i të ri që do të jetë në marrëdhënie punësimi në vijim. Të dhënat do të fshihen nga sistemi i ruajtjes së tyre në momentin e shkëputjes së marrëdhënies të punës mes palëve.”*

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Të dhënat personale të transferuara mund të ruhen jo më gjatë se kohëzgjatja e marrëdhënies kontraktuale të punësimit mes punëmarrësit dhe punëdhënësit”*.

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 *“Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*, Turqia nuk përfshihet në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, subjekti kontrollues *“Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi”* Zyrë Përfaqësimi është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim, subjekti përveç Formularit të Aplikimit për aprovimin e transferimit të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, nëpërmjet Autorizimit të Komisionerit, ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

- Deklaratë pëlqimi për informimin dhe përpunimin e të dhënave personale;
- Marrëveshje për transferimin e të dhënave ndërmjet “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri dhe “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” i vendosur në Turqi;
- Aneksi A;
- Aneksi B;
- Formular njoftimi.
- Ekstrakt i Regjistrisë Tregtare për të dhënat e subjektit “Për degët ose zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja”;
- Ekstrakt Historik i Regjistrisë Tregtare për të dhënat e subjektit “Për degët ose zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja”.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimit të përmbajtjes së tyre rezulton se ky transferim të dhënash personale është në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për “Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” Zyrë Përfaqësimi plotëson kërkesat ligjore për t’u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit, 9 pika 2 dhe nenit 26 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

#### **V E N D O S A :**

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” Zyrë Përfaqësimi lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave “Nobel Ilac Sanayyi ve Ticaret Anonim Sirketi” e vendosur në Turqi kategorinë e të dhënave personale “nëpunës”, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Jeta profesionale;
- Numri i sigurimit shoqëror;
- Formimi – Diplomat – Medaljet;
- Adresa (karakteristikat e banesës);
- Foto;
- Informacionin e kontaktit, vlerësimet e pikëve të performancës, nënshkrimi.

Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për autorizim mbi transferimin e të dhënave personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me “*rritjen e performancës së aktiviteteve të kompanisë brenda hapësirave ligjore*” dhe “*rekrutime brenda kompanisë dhe ofrimin e mundësive të karrierës*”.

2. Të dhënat personale të lejuara për t’u transferuar (parashikuar në pikën 1), nuk do të ruhen më gjatë se kohëzgjatja e marrëdhënies kontraktuale të punësimit mes punëmarrësit dhe punëdhënësit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 30/3 /2021

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

